

REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK/DMP	Nr Prot	03-4147/12
Dep.		Prot No	
Nr. Hec	02	Data	14-11-2012
Proj. tematica		Datum	
Nr. pages		Date	
PRINTIME			

GJ.L Nr. 1122/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, më pjesëmarrjen e Sek. Juridike Nexhmije Abazxhik, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencioni Kundër Korrupsionit i Republikës së Kosovës, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 18234/2012 të dt. 24.09.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39, konform nenit 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 24.10.2012 merr këtë:

#### A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është pjesërisht e BAZUAR.

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 18234/2012 të dt. 24.09.2012, ashtu që të pandehurit Flamur Keqa nga Prishtina, për veprën kundërvajtëse nga neni 5,6 dhe 8 par. 1 dhe 2 të sanksionuar sipas nenit 17 par. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publike, me nr. 04-L-050, i shqiptohet gjoba në shumë prej 600 (gjashtëqind) Euro, konform të nenit 9 të LK-së të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do të i zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur 15 Euro për një ditë burgimi. Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve në procedurë.

#### A R S Y E T I M

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr. regj. 18234/2012 të dt. 24.09.2012 të pandehurin Flamur Keqa nga Prishtina, e ka shpall përgjegjës sepse: si Drejtorë i Departamentit të Tregtisë në MTI-së nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit Antikorrupsion, në afatin e paraparë ligjor për vitin 2011, edhe pse ka qenë e njoftuar me kohë për këtë obligim ligjor është vonuar deri më dt. 05.04.2012, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë, me ç,veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 par. 1 dhe 2, neni 8 par.1, 2 të sanksionuar sipas nenit 17 par. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publike, nr. 04/L-050, dhe i ka shqiptuar masën e QORTIMIT në vështrim të nenit 10 të LK.

Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15 (pesëmbëdhjetë) Euro.

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit të Republikës së Kosovës, ka paraqitur ankesë, për shkak të: vendimit mbi dënimin, me arsyetim se Gjykata për kundërvajtje në Prishtinë, duke aplikuar nenin 10 të LK. i shqipton masën edukative Qortim, edhe pse të gjitha faktet dhe rrethanat tregojnë se i pandehuri e ka kryer veprimin kundërvajtës. Deklarimi i pasurisë edhe përgjegjësi e lartë publike dhe rregullohet me Ligj të veçantë. Gjykata e lartë përmendur nuk e ka shqiptuar dënimin e merituar ndaj të pandehurit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-050, por këtë dënim e zbutë një masë të madhe ku bie në kundërshtim me rregullat mbi zbutjen e dënimit të përcaktuar në nenin 9 të LK. Propozon që aktvendimi mbi dënimin i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim ose të njëjtit ti shqiptohet dënimi meritor në pajtim me Ligjin nr. 04/L-050.

2.

Kolegji i kësaj gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës konstatoi se ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar.

Nga provat e deponuara dhe administruara nga Gjykata e shkallës së parë, në bazë të deklaramit të pandehurit Flamur Keqa, në Seancën e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 18.09.2012, i cili në mbrojtjen e vet e ka pranuar kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, si dhe shkresat tjera të lëndës, pa dyshim se është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri e ka kryer veprën kundërvajtëse për të cilën mbanë përgjegjësi kundërvajtëse. Andaj Kolegji konstatoi se Gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar drejtë dhe në masë të plotë gjendjen faktike, megjithatë të pandehurit i ka shqiptuar masën e Qortimit e cila nuk është adekuate me peshën e veprës së kryer kundërvajtëse.

Kolegji konstatoi se masa e shqiptuar nuk është adekuate dhe në proporcion me veprën e kryer kundërvajtëse nga se, nga gjykata e shkallës së parë nuk është vërtetuar se ekzistojnë rrethanat lehtësuese në atë masë që të pandehurit Flamur Keqa, t,i shqiptohet masa e Qortimit, e cila nuk është në proporcion me peshën e veprës, rrethanat nën të cilat është kryer vepra si dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, andaj për arsyet e cekura më lartë ndryshohet aktvendimi i goditur duke i shqiptuar të pandehurit gjobën në shumë prej 600 (gjashtëqind) Euro, konform të nenit 9 të LK-së duke pas për bazë edhe dispozitat e nenit 7 të LK dhe duke llogaritur se edhe me këtë gjobë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ashtu që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra të tilla apo të ngjashme.

Andaj në vështrim të nenit 221 të LMK u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankesë.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.**

GJ.L nr. 1122/2012 të dt. 24.10.2012.

SEK. JURIDIKE,  
Nexhmije Abazxhik

